



REPUBLICA E KOSOVËS  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË  
OSNOVNI SUD GJILANE - OGRANAK NOVOBËRDË  
30.05.2017  
N. Ken

P.nr.70 / 2016

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË -**  
**Departamenti i përgjithshëm,** përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me proqesmbajtsen Emine Zubaku, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. A. nga fsh. Komuna e Gjilanits, për shkak të dy veprave penale, lidja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II. nr. 2004/ 2016, të datës 08.11.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurori i Shtetit, Mr.sc. Ismet Ukshini, pas mbajtes së seancës së shqyrtimit gjyqsor fillestar publik, më 20.03.2017, ndërsa me 21.03.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari A. A.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati A. A., dhe e ëma I. A., e lindur H. A., i lindur më 20.05.1965 në me vendbanim në fsh. , tek restoranti, ' ' ; shqiptar, shtetase e R. Kosovës, Ka të kryer shkollën e mesme, i vej, prind i dy fëmijve, e gjendjes së varfur ekonomike, deri me tani i pa gjykuar dhe nuk zhvillohet ndonji procedur tjetër penale ndaj tij.

## Ë s h t ë f a j t o r ë

Sepse:

Me date 19.07.2016 në kohë të pa përcaktuar në shtëpinë e tij në fsh. , si konsumator i energjis elektrike, me qëllim që vetit ti sjelli përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka përfituar nga shërbimet komunale, në atë mënyrë që për shkak të borxhit që konsumatori kishte ndaj kompanis së "KEDSI-it", të njejtit i është konfiskuar njehsori elektrik, ndërsa gjatë kontrollit të bërë nga punëtorët e kompanis "KEDS" të njejtit kanë konstatuar se i akuzuari ishte kyqur në rrjetin elektrik, pa njehsor elektrik edhe e ka shfrytzyar energjin elektrike, dhe kështu e ka pamundsuar rexhistrimin e shpenzimeve të hargjuara të energjis elektrike, në këtë mënyrë me veprimet e veta të dëmtuarës "KEDSI-it" Distriktit në Gjilan i ka shkaktuar dëm në shumë prej 264.48 euro.

*Me çka ka kryer veprën penale , lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-ës.*

## *II.*

*Sepse:*

*Me datën 30.09.2016, në kohë të pacaktuar, në shtëpin e tij në fsh. [illegjibël], si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetit ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka përfituar nga shërbimet komunale, në atë mënyrë që për shkak të borxhit që konsumatori kishte ndaj së "KEDSI-it", të njejtit iu është konfiskuar njehsori elektrik, ndërsa gjatë kontrollit të bërë nga punëtorët e kompanis "KEDS", të njejtit kanë konstatuar se i akuzuari ishte kyqur direkt në rrjetin elektrik, pa njehsor elektrik e ka shfrytëzuar energjinë elektrike, kështu I ka pamundësuar rexhistrimin e shpenzimeve të hargjuara të energjis elektrike, në këtë mënyrë I akuzuari me veprimet e veta të dëmtuarës "KEDSI-it" Distrikti në Gjilan I ka shkaktuar dëm në shumë prej 145.31 euro*

*-me çka ka kryer veprën penale, lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 të KPRK-se,*

*Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41, 46,51, 52, 64,73,74, 75 dhe 76 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPRK-së.*

### *I SHQIPTON*

*Për veprën penale si në dispozitivin nën I. me dënim burgu të kushtëzuar në kohë zgjatje prej 5 (pes) muajve, dhe me dënim me gjobë në shumë prej 150. (nji qind e pesdhjet) €,*

*Për veprën penale si nën dispozitivin II. Me dënim burgu të kushtëzuar në kohëzgjatje pre 3 (tre) muajve, dhe gjobë në shumë prej 150 (një qindë e pesdhjetë) eur.*

*Andaj gjykata në pajtim me nenin 80 të KPRK-ës*

### *E GJYKON*

*Me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 7(shtatë) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej 300(treqindë) euro e të cilat dënime nuk kanë për tu*

ekzekutuar në qoftes e akuzuari në afat prej 18(tetëmbdjetë) muajve nuk kryen ndonji vepër tjetër penale, në të kundërtën ky dënim i kushtëzuar do të revokohet.

I akuzuari obligohet ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipa llogaris përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor të shumën prej 20€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së aktgjykimit.

E dëmtuara ,KEDS, Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore, në Gjilan, me aktakuzën e ushtruar me shkrim, PP.II.nr.2004/2016 , të datës 08.11.2016, e ka akuzuar A . A , nga Fsh. .K.Novobërdë, për shkak të dy veprave penale në lidhja e paautorizuar në shërbime , nga neni 321 të KPRK-se.

Prokurori i shtetit Mr.sc. Ismet Ukshini, në seancën fillestar ka deklaryar: në tërsi mbetem pranë aktazës së ushtruar me shkrim dhe propozoj që i akuzuari të shpallet fajtor për veprat e kryera dhe të njejtit ti shqiptohet denimi meritor sipas ligjit, gjithnji duke i marrur për bazë të gjitha rrethanat si ato lehtsuese ashtu edhe ato rënduese.

I akuzuari A . A në seancën fillestare ka deklaryuar: aktakuzë e lezuar nga ana e prokurorit të shtetit e kam kuptuar në tërsi, e ndiej vehten fajtor, dhe e pranoj fajësinë për veprat të cilat mi vënë në barrë aktakuza, pendohem për të njejtën , dhe i premtoj gjykatës se nuk do të kryej vepra të kësaj natyre, dhe kërkoj nga gjykata që brenda mundësive ligjore të më shqiptoj një dënim sa më i butë .

Me qenë se i akuzuari në shqyrtimin fillestar të mbajtur pranë kësaj gjykate në këtë qeshtje penale e ka pranuar fajsin për të gjitha pikat e aktakuzës, e me këtë sipas vlersimit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë qeshtje penale nuk është kontestuese, sepse përpos pranimin të fajsis nga ana e vetë të akuzuarës, një pranim i tillë i fajsisë ka mbështetje edhe nga provat e grumbulluara që gjenden në shkresat e lëndës si që janë proqesvërbalet si dhe fotodokumentacioni i hartuar nga vendi i ngjarjes, se i njejejt vullnetarisht e ka pranuar fajsin, andaj gjykata vazhdoi

shqyrtimin proqesim ndaj të njejtit pa shjkuar fare në shqyrtim gjyqsor dhe pa fjalën përfundimtare kështu në pajtim e dispozitën e nenit 248 par. 4 të KPRK-ës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata, gjykata i pat parasysh të gjitha rrethanat sikurse ato lehtsuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në përcakrimin e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-ës, dhe kështu si rrethanë lehtsuese të akuzuarit ia mori për bazë sjelljen korrekte gjatë séances së shqyrtimit gjyqësor, pranimin e fajsisë dhe pendimin për të njejtën, premtimin se në të ardhmën nuk do të kryej vepra tjera penale, se për herë të pare ka rënë ndesh me ligjin, gjendjen ekonomike dhe familjare, se i njejtë është e shtyer në moshë, i vej, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe motivet për kryerjen e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, dhe duke i marrë për bazë të gjitha këto fakte të njejtit i shqiptoi dënimin më afër të përshkruar si dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se vetëm me kët dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me ligj në mënyrë që akuzuarin ta parandalojë nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandalojë dhe personat tjer nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për shpenzimet e priocedurës penale është I bazuar në dispozitën e nenit 450 parag.1 nën parag. 2 .6 të KPPRK-së.

Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike është I bazuar në dispozitën e nenit 463 të KPPK-ës.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË.**

**- Departamenti i përgjithshëm.**

**P.nr. 70 / 2016 më 14.02.2017.**



Gjyqtari:

Hasan Sadiku

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.